



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 112-6072

Më datë 02.02.2026

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenin 13, nenit 58, pika (e) lidhur me nenin 60, paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" e duke u bazuar në nenin 3, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2023, për procedurat e emërimit të nënkryetarëve në Komuna dhe konform nenit 30 dhe 45, lidhur me nenin 48, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e nënkryetares të Komunës së Suharekës

1. **Arta GASHI** e lindur me 19.12.1985, me vendbanim në Rr. "Ismail Qemajli", në Suharekës, me profesion Sociologe, **emërohet Nënkyetare e Komunës së Suharekës.**
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetares të Komunës, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", përkatësisht me nenin 60, të këtij Ligji, në udhëzimin administrativ (MAPL) Nr.03/2023 për procedurat e emërimit të nënkryetarëve në Komuna si dhe me nenin 48, të Statutit të Komunës së Suharekës.
3. Ky emërim fillon nga data **02 shkurt 2026** dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. E lartpërmendura, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është i obliguar të bëjë deklarinë e pasurisë, në pajtim me nenin 7, lidhur me nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-108, për deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 21/2022" si dhe deklarinë pas përfundimit nga funksioni, brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me nenin 10, të këtij Ligji.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës